



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË

Nr. 8493/ prot.

Tiranë, më 5.11.2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. Nr.1795, datë 11.04.2016.

SHOQËRISË "STONE MARBLE VALONA SH.P.K
Kuç, Përroi i Laskos, Himarë, Vlorë

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku "Vasil Shanto", Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë

Shoqëria "STONE MARBLE VALONA" sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1795, datë 11.04.2016, për mineralin ranor silicor, në Objektivin "Kuç", Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 4877, datë 21.10.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 8493 Prot., datë 22.10.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1795, datë 11.04.2016, për mineralin ranor silicor, në Objektivin "Kuç", Bashkia Himarë, Qarku Vlorë. pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma "ç" të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit**

për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1795, datë 11.04.2016, për mineralin ranor silicor, në Objektivin "Kuç", Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1795, datë 11.04.2016, për mineralin ranor silicor, në Objektivin "Kuç", Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRI**

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËS DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

CENG KLOST